

## VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

në dhomë këshillimi, më datë 13.12.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

**PADITËS:**           **Keti Kumbe (Margariti)**

**I PADITUR:**       **Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**

**OBJEKTI:**       Anullimin e Urdhrit nr. 527 Prot., datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe detyrimin e palës së paditur të më rikthejë në vendin e mëparshëm të punës.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e 2 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së marrëdhënies së punës.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e një 15 ditëshi për çdo vit pune pranë paditësit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32, 47, 153 të Kodit të Procedurës Civile; Neni 4, 7, 12, 21, 140/1/1, 143, 144, 145, 153, 155 dhe 203 të Kodit të Punës.

**Me Vendimin nr. 701, datë 23.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** është vendosur: *“1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile me nr. Regj. Them. 4882, datë regjistrimi 17.09.2013, që i përket paditëses Keti Kumbe (Margariti). 2. Dërgimin për shqyrtim të kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie.”*

**Me Vendimin nr. 3257, datë 29.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit** është vendosur: *“- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2170, datë 07.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”*

**Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me datë 03.10.2014.** Rekursi rezulton t'i jetë njoftuar palëve dhe nuk rezulton të ketë kundërrekurs.

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

**V E N D O S I :**

Prishjen e vendimit nr. 3257, datë 29.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë por me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 13.12.2017

**Nr. 31001-01017-00-2015 i Regjistrimit Themeltar  
Nr. 00 - 2017 - 2612 i Vendimit ( 886 )**